



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0544

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Geo - Group " SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KOMUNA E PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët” me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, me 16/11/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE " Geo- Group " SH.P.K. me nr. 2023/0544, e datës 03/08/2023, kurse vendimi i AK KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët” me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " Geo- Group " SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.05.2023 Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve për ndërtim te ulet” me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1. Ndërsa me datën 11.07.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me te cilin ka shpërblyer me kontratë “N.SH.”3 D- PROJECT”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 300,000.00 €.

Me 15.07.2023, OE " Geo- Group " SH.P.Kka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 24.07.2023, Autoriteti Kontraktues ka aprovuar si të bazuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim dhe ka kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim.

Me 03.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga e OE " Geo- Group " SH.P.Kme nr. 544/23 lidhur me aktivitetin “Hartimi i projekteve për ndërtim te ulet” me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues " Geo- Group " SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendonse “OE ankues pretendon se ka plotësuar kërkesën e DT-së duke dëshmuar se ka realizuar shërbime të ngjashme në 3 vitet e fundit në vlerë më të lartë se 200 000.00 Euro. Shoqëria “ILLYRIAN COUNSULTING ENGINEERS” sh.p.k në cilësinë e bartësit të Grupit konzerciumit ka dorëzuar tender dokumentet e kërkuara që janë në listë të kontratave të

realizuara duke plotësuar Aneksin 7 të DT-së ku janë dhënë të dhënat për 6 dëshmi të realizimit shërbimet e ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit me një vlerë totale prej 685 743 Euro, si dhe janë paraqitur referencat, certifikatat e kryerjes së shërbimeve bashkë me kontrata si dhe OE i rekomanduar për kontratë i në paramasën e tij ka ofruar më shumë se dy numra pas presjes dhjetore gjegjësisht tre”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE " Geo- Group " SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 43.1 dhe 43.2 Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, si dhe nenin 7, dhe 56 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe të shpallen fitues.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 544/23, ndërsa me datë 30/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0544 me rekomandimet si në vijim: *“Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar *“përmes nenit 108/A të LPP është përcaktuar se “Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues”. Në anën tjetër përmes nenit 109 paragrafit 1 të LPP është përcaktuar se “Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji”. Sa i përket termit “palë e interesuar” përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP është përcaktuar se “Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”. Operatori ekonomik ankues “GEO-GROUP” Sh.P.K. me datë 15.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 11.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët” me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1. Përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim pala ankuese ka kërkuar nga autoriteti kontraktues që të anulohet njoftimi mbi*

vendimin e autoritetit kontraktues të datës 11.07.2023 ashtu që të kthehet në rivlerësim aktiviteti i prokurimit. Autoriteti kontraktues ka trajtuar me kujdes kërkesën për rishqyrtim të palës ankuese me ç'rast është gjetur se janë paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij të dytë dhe pjesërisht pretendimin e tij të parë. Për këto arsye autoriteti kontraktues me datë 24.07.2023 ka marrë vendimin përmes të cilit është miratuar si e bazuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim ashtu që është anuluar njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 11.07.2023 ndërsa aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim. Pala ankuese me datë 03.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP përmes të cilës ka kërkuar që të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 11.07.2023 ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim. Propozimi për petitum në ankesë është i njëjtë sikurse propozimi për petitum në kërkesën për rishqyrtim. Mirëpo njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 11.07.2023 tanimë është anuluar përmes vendimit të datës 24.07.2023 me të cilën është vendosur ndaj kërkesës për rishqyrtim. Po ashtu edhe aktiviteti i prokurimit tanimë është kthyer në rivlerësim. Pra propozimi për petitum në ankesë është i palejuar pasi që tanimë autoriteti kontraktues ka realizuar veprimet që ankuesi kërkon të realizoj përmes ankesës. Fakti që është për t'u çuditur në këtë rast është se për palën ankuese nuk është fare kontestuese se autoriteti kontraktues e ka miratuar kërkesën për rishqyrtim duke e anuluar njoftimin mbi vendimin dhe duke e kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit. Mirëpo pjesa më e çuditshme në gjithë këtë lëndë është kur edhe eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që të anuloj njoftimin mbi vendimin dhe që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim pavarësisht që autoriteti kontraktues tanimë i ka ndër marrë këto veprime që i rekomandon eksperti. Duke marrë parasysh të thënat më sipër mund të konfirmohet se pala ankuese në këtë rast nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP pasi që nuk ka dëshmuar as interes material dhe as nuk argumentuar ndonjë dëm eventual nga shkelja e pretenduar. Kjo për arsye se ankuesi përmes ankesës kërkon që të anulohet një vendim i cili tanimë është anuluar nga autoriteti kontraktues si dhe kërkon që të aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim pavarësisht që ky aktivitet tanimë ndodhet në rivlerësim. Me fjalë të tjera autoriteti kontraktues e ka miratuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim të palës ankuese prandaj ankesa është tërësisht e palejuar dhe e pakuptimtë. Në anën tjetër eksperti shqyrtues nuk e ka marrë parasysh fare këtë gjendje faktike dhe juridike në raportin e tij me nr. 2023/0544. Rrjedhimisht ankesa është parashtruar në kundërshtim të plotë me nenin 108/A dhe 109 të LPP sikurse janë cituar më sipër. Nga sa u tha më sipër kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të hedh poshtë si të palejuar ankesën e palës ankuese si dhe t'i tërheqë vëmendjen ekspertit shqyrtues që të jetë më i kujdesshëm për respektimin e neneve 113 dhe 114 të LPP gjatë realizimit të ekspertizave në të ardhmen. Provë: Vendimi i autoritetit kontraktues i datës 24.07.2023. Provë: Kërkesa për rishqyrtim e datës 15.07.2023," ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit

shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE " Geo- Group " SH.P.Keksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0544 fillimisht ka sqaruar se OE ankues në letrën standarde për tenderuesit e eliminuar është eliminuar për dy arsye të cilat janë: 1 GOE ankues nuk ka plotësuar kërkesën e DT-së, nuk ka arritur të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në tre vitet e fundit min 200 000.00 Euro për projekte të infrastrukturës rrugore (min. 51% bartësi i konzorciumit). Si dhe arsyeja e dytë GOE ankues nuk ka plotësuar kërkesën e DT-së, OE-ik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi bankar i OE-ik, gjatë tri viteve të fundit ka qenë jo me pak se 300,000.00 euro - ((51% Bartësi i konzorciumit).

GOE ankues ka paraqitur ankesë në AK lidhur me arsyet e tij të eliminimit si dhe ka pretenduar që OE i propozuar për kontratë është i pa përgjegjshëm. Me dt. 24.07.2023 kërkesa për rishqyrtim i është aprovuar si pjesërisht e bazuar dhe AK ka vendosur që të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së i dt. 11.07.2023 dhe të kthehet në rivlerësim aktiviteti i prokurimit. AK nuk ka bërë rivlerësim të aktivitetit të prokurimit dhe ankesa është parashtruar në OSHP.

Me tutje eksperti shqyrtues ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i bazuar pasi që *“Eksperti Shqyrtues, konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “OE-ik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit minimum 200,000.00 euro, për projekte të Infrastrukturës rrugore (min 51% bartësi i konzorciumit). Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve”. Eksperti Shqyrtues, sqaron se në marrëveshjen e themeluar me dt. 1 Qershor 2023 në mes të OE “ ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SH.P.K dhe OE “GeO – Group” sh.p.k, është përcaktuar që si përfaqësues, operatori ekonomik*

kontaktues i ketij konzerciumi "GeOGroup" sh.pk, ndërsa si Lider/Bartës i konzerciumit është caktuar OE "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" SH.P.K . Lideri i Konzerciumit "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" SH.P.K ka plotësuar Aneksin 7 të DT-së ashtu siç është kërkuar duke përshkruar kontratat e realizuara me përshkrim të shkurtër, datën e fillimit, datën e mbarimit, shumën, emrin e blerësit, emailin e blerësit dhe numrin e telefonit të blerësit. Gjithashtu, për projektet e listuara në listë OE ankues ka bashkangjitur edhe dëshmit si: Vërtetim realizimit të kontratës, kontrata etj. Eksperti Shqyrtues vlerëson se nuk mund të eliminohet OE ankues në rastin konkret për faktin se nuk ka të theksuar në mënyrë decisive infrastrukturë rrugore, mirëpo në kontratat e paraqitura në ofertë janë të përfshira edhe hartim të projekteve për rrugë dhe kërkesa e DT-së është projekte te ngjajshme e jo të njejta siç pretendon AK. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm. ."

Pretendimi i dyte (II) ankimorështë i bazuar pasi që "OE të rekomanduar për kontratë i cili në paramasën e tij ka ofruar më shumë se dy numra pas presjes dhjetore gjegjësisht tre, eksperti shqyrtues sqaron se në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim AK e ka konsiderua si të bazuar pretendimin e OE ankues, mirëpo nuk e ka shpallë të pa përgjegjshëm OE të propozuar për kontratë. Eksperti Shqyrtues sqaron se në Rregulloren për prokurim publik në nenin 17.11 është përcaktuar "Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme. Në rast se AK lejon çmime me më shumë se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK një informatë të tillë duhet t'a përcaktoj në dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde", në rastin konkret AK nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë në DT që lejon që operatorët ekonomik të ofrojnë çmime me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore, andaj oferta e OE të propozuar për kontratë do të duhej të konsiderohet e pa përgjegjshëm për shkak të ofrimit të çmimeve me tre numra pas presjes dhjetore. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "OE Geo- Group " SH.P.K" Argumentimi në raportin e ekspertit është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "OE " Geo- Group " SH.P.K. janë tërësisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 11.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët” me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP nisat gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Paneli shqyrtues në bazë të shkresave të cilat i ka në dispozicion ka gjetur se aktiviteti i prokurimit veç se është kthyer në ri-vlerësim, ku AK e ka aprovuar pjesërisht kërkesën për ri-shqyrtim, por OE me të drejtë për shkak të mos aprovimit të tërësishëm të pretendimeve ankimore ka paraqitur ankesë në OSHP.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " Geo- Group " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: